



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
P-067  
Prishtinë, më 16 dhe 17 qershor 2016

**P R O C E S V E R B A L**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 16 DHE 17 QERSHOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedojë me rendin e ditës, kryetari i njoftoi deputetët me Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim: Shukri Buja, kandidat i subjektit politik PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, zëvendëson ish-deputetin z. Enver Hoxhaj; Fatmir Xhelili, kandidat i subjektit politik PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, zëvendëson ish-deputetin z. Azem Sylaj; Driton Çausi, kandidat i subjektit politik “Vetëvendosje”, zëvendëson ish-deputetin z. Besnik Bislimi.

Kryetari i ftoi deputetët e rinj që ta japin betimin. Në sallë, nga deputetët e rinj, ishte i pranishëm vetëm deputeti Fatmir Xhelili.

Kryetari e lexoi tekstin e betimit, kurse deputeti Fatmir Xhelili e shqiptoi fjalën “betohem” dhe e nënshkroi deklaratën e betimit.

Ndërsa deputetët e rinj, Shukri Buja dhe Driton Çausi, betimin do ta japin në seancën e radhës.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të rendit të ditës, si në vijim:

## **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Shaip Muja, Glauk Konjufca, Blerta Deliu-Kodra, Qerim Bajrami, Mytaher Haskuka, Albulena Haxhiu, Besa Baftiu dhe Elmi Reçica, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me arsyet e procedimit të Projektligjit nr. 05/L-099 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, në lidhje me atë se sa ka ndikuar Ligji për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të Kosovës në zvogëlimin e numrit të të rinjve nga Kosova për t'iu bashkuar luftës në Siri.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetes Alma Lama.

Deputeti Raif Qela i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e Qeverisë së Kosovës për kthimin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës, të dëbuar nga pronat e veta, për t'u kthyer në banesat dhe shtëpitë e tyre në komunën e Mitrovicës Veriore.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me angazhimin e disa ministrave në Kabinetin qeveritar për pranimin e Kosovës në UNESCO, UEFA dhe FIFA, si dhe brohoritjet e tyre gjatë fushatës zgjedhore të Serbisë, që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me angazhimin e pjesëtarëve të “Mbrotjtjes Civile”.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për të parandaluar ndërtimin e “Luginës së Diellit” në Mitrovicën Veriore.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtroi pyetje zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi lidhur me zbatimin e Memorandumit me punëtorët e RTP-së për zgjidhjen e çështjes së tyre.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me përfundimin e segmentit rrugor nga Klina-Skenderaj-Polluzhë dhe fillimin e segmentit rrugor nga Polluzha-Drenas-Komoran.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Abdyl Ymeri.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me qëndrimin e kësaj ministrie për grevën e punëtorëve të sigurimit në Spitalin Rajonal të Gjilanit.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj deputetes Besa Baftiu.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me veprimet e kësaj ministrie për zbatimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj deputetes Besa Baftiu.

Deputeti Salih Salihu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me ndërtimin e një lidhjeje për qytetarët e komunës së Vitisë në autostradën Prishtinë-Han i Elezit.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Salih Salihu.

Deputetja Salihe Mustafa i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, lidhur me shumën e ndarjes së mjeteve financiare për OJQ-të –Strehimoret që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetes Salihe Mustafa.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, lidhur me mënyrën e ndarjes së buxhetit për Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale nëpër komuna.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetes Mexhide Mjaku-Topalli.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me përdorimin e formulës për alokimin e mjeteve financiare për Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale nëpër komuna.

Ministri Abdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, lidhur me numrin e kthimit të qytetarëve të Kosovës nga vendet perëndimore prej shkurtit të viti 2015 deri më 30 maj 2016, si dhe planin për integrimin e tyre.

Ministri Skënder Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Memli Krasniqi, lidhur me veprimet e ministrisë për të parandaluar shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, që është në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, lidhur me çështjen e pensioneve të shtetasve të Kosovës që janë pensionuar në Zvicër, por që nuk i marrin pensionet.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Kujtim Shala, lidhur me zbatimin e Ligjit për trashëgimin kulturore dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Kulturës, Kujtim Shala, nuk ishte i pranishëm në sallë.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 9 qershor 2016.

Kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika:

- Shqyrtimi i projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, dhe
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 70,  
Kundër ----- 12,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet edhe me këto pika:

*18. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, dhe*

*19. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.*

#### **4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10**

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 9 qershor 2016.

Andaj, në seancën e sotme procedohet vetëm me votim.

Kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 75,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

## **5. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për procedim dhe miratim.

Raportin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Xhevahire Izma.

Kryetari i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë anëtarët e Komisionit votues me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Kuvendi, me propozimin e grupeve parlamentare, e formoi Komisionin votues në këtë përbërje:

- 1.Xhevahire Izma, nga GP i PDK-së,
- 2.Besa Gaxheri, nga GP i PDK-së,
- 3.Shqipe pantina, nga GP i LVV-së,
- 4.Bojan Mitiq, nga GP i LS, dhe
- 5.Kujtim Paçaku, nga GP “6+”.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevahire Izma. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 91 deputetë. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

Avdyl Hyseni i ka fituar 62 vota;  
Musa Dragusha i ka fituar 41 vota;  
Mentor Hoxha i ka fituar 20 vota;  
Ivica Ivanoviqi i ka fituar 40 vota;  
Dua Kadriu i ka fituar 37 vota;  
Natasha Taniq nuk ka fituar asnjë votë.

Në bazë të rezultateve të votimit, konstatohet se anëtar i Bordit për Ankesa të Medieve, me mandat trevjeçar, në këtë rund zgjidhet vetëm Avdyl Hyseni, ndërsa vazhdohet me rundin e dytë, me kandidatët: Musa Dragusha, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq dhe Dua Kadriu.

### **Rundi II**

Kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevahire Izma. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë. Të pavlefshme janë tri fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

Musa Dragusha i ka fituar 45 vota,  
Mentor Hoxha i ka fituar 18 vota,  
Ivica Ivanoviqi i ka fituar 35 vota,  
Dua Kadriu i ka fituar 31 vota.

Në bazë të rezultatit të votimit, konstatohet se anëtar i Bordit për Ankesa të Medieve me mandat trevjeçar zgjidhet Musa Dragusha, ndërsa në rundin e tretë votohet për kandidatët: Ivica Ivanoviq dhe Dua Kadriu.

### **Rundi III**

Kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në rundin e tretë, në emër të Komisionit votues raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaqi. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 80 deputetë. Të pavlefshme janë 23 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

1. Ivica Ivanoviq i ka fituar 29 vota.
2. Dua Kadriu i ka fituar 28 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit konstatohet se me numrin e votave të fituara nuk zgjidhet asnjëri nga dy kandidatët e propozuar për anëtar në Bordin e Ankesave të Medieve.

Pas tri rundeve të votimit të fshehtë për anëtarë të Bordit të Ankesave të Medieve, kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Z. Avdyl Hyseni zgjidhet kryetar i Bordit për Ankesa të Mediave.
2. Z. Musa Dragusha zgjidhet anëtar i Bordit për Ankesa të Mediave.
3. Mandati i të zgjedhurve në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
4. Për një anëtar tjetër të Bordit për Ankesa të Mediave duhet të shpallet konkursi.

### **6. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pas intervistimit të kandidatëve për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit Kuvendit i ka propozuar dy kandidatët e mundshëm për pozitën e drejtorit të kësaj agjencie.

Kryetarja e Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi vendosi që përbërja e njëjtë e Komisionit votues të vazhdojë edhe me procedurat e zgjedhjes së drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaqi. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë, të pavlefshme janë 7 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

1. Burim Sadiku i ka fituar 31 vota,
2. Shaip Havolli i ka fituar 47 vota.

Kryetari deklaroi se Kuvendi, me votim të fshehtë, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Z. Shaip Havolli zgjidhet drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, me mandat pesë (5) vjeçar.
2. Mandati i drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit fillon nga 24.09. 2016.

### **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

Kuvendi, me propozimin e kryetares së Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Flora Brovina, këtë projektligj e shtyu për ndonjë seancë tjetër të radhës, me arsyetimin se komisioni ka nevojë për konsultime shtesë me Qeverinë e Kosovës lidhur me nenin 18 të këtij projektligji.

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti dhe e arsyetoi deputeti Fadil Beka.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 21 amendamente.

Lidhur me amendamentet e propozuara në këtë projektligj diskutoi deputetja Besa Baftiu, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet përnjëherë.

Kuvendi i miratoi amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional nga 1 deri 21.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 68,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve.

### **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Muhamet Mustafa.

Në këtë Projektligj janë propozuar gjithsej 65 amendamente.

Deputeti Shaip Muja e propozoi edhe një amendament (66) në këtë projektligj.

Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet përnjëherë, nga 1-65.

Kuvendi i miratoi amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nga 1 deri 65.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim amendamentin nr. 66, të propozuar nga deputeti Shaip Muja.

Kuvendi, me 63 vota për, 3 kundër dhe 5 abstenim, e miratoi amendamentin nr. 66 të propozuar nga deputeti Shaip Muja.

Në fund, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 64,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-081 për energjinë.

### **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë elektrike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Muhamet Mustafa.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 58 amendamente.

Për amendamentin nr. 1 janë dhënë dy propozime:

- A) Propozimi i Komisionit Funksional, dhe
- B) Propozimi i Grupit Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kryetari i hodhi në votim 56 amendamente përnjëherë, të cilat me shumicë votash i miratoi Kuvendi. Ndërsa amendamenti nr. 1 dhe amendamenti nr. 14 u votuan veçmas.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet nr.1A, të Komisionit Funksional dhe amendamentin nr. 14, të riformuluar sipas propozimit të deputetit Muhamet Mustafa.

Pastaj kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 58,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-085 për energjinë elektrike.

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë elektrike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Muhamet Mustafa.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 44 amendamente.

Për amendamentet nr. 7 dhe 14 ishin nga dy propozime:

- A) Propozimi i Komisionit Funksional dhe
- B) Propozimi i Grupit Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Deputeti Fikrim Damka, në emër të GpP “6+”, deklaroi se propozimet e këtij grupi për amendamentin nr. 7 janë përfshirë në propozimin e Komisionit Funksional, ndërsa për amendamentin nr. 14 nuk janë përfshirë.

Kryetari i hodhi në votimit përnjëherë të gjitha amendamentet, me përjashtim të amendamenteve nr. 14, 17 dhe 19, të cilat me shumicë votash i miratoi Kuvendi. Amendamentet nr. 14, 17 dhe 19 u votuan veç e veç.

Kuvendi veçmas e miratoi amendamentin nr. 14A, propozimin e Komisionit Funksional, si dhe amendamentet 17 dhe 19, të riformuluara sipas propozimit të deputetit Muhamet Mustafa.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Nuk pati vota të mjaftueshme për miratimin e këtij projektligji.

\* \* \*

Kuvendi, me 60 vota për, 1 votë kundër dhe 7 abstenime, e ka miratuar Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë në vazhdimin e seancës plenare më 17 qershor 2016.

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazin natyror**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për gazin natyror dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Muhamet Mustafa.

Në këtë projektligj ishin propozuar 50 amendamente.

Kuvendi i miratoi në tërësi amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nga 1 deri 50.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 55,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-082 për gazin natyror.

## **13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e zëvendësauditorit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur propozim-vendimin për miratim.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi propozim-vendimin.

Lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës diskutuan edhe deputetët Nuredin Ibishi dhe Shqipe Pantina.

Kryetari e hodhi në votim Propozim-vendimin për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Nuk pati vota të mjaftueshme për miratimin e këtij vendimi.

\* \* \*

Kuvendi, me 67 vota për, 7 vota kundër dhe 2 abstenime, në vazhdimin e seancës plenare më 17 qershor 2016 e ka miratuar këtë:

## V E N D I M

1. Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës i caktohet paga në shumën prej 1 875,90 euro bruto në muaj, si dhe shtesat që janë të barasvlershme me shtesat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

2. Niveli i pagës dhe shtesat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zbatohet duke filluar nga data 30 mars 2016 deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

### **14. Shqyrtimi i raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Lidhur me raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015 diskutuan këta deputetë: Abdyl Ymeri, në emër të GP të PDK-së; Naser Osmani, në emër të GP të LDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së, si dhe deputetët Shpejtim Bulliqi, Faton Topalli, Safete Hadërgjonaj dhe Besa Gaxheri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 60,  
Kundër ----- 15,  
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015.

### **15. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015 diskutoi edhe deputetja Safete Hadërgjonaj.

\* \* \*

Kuvendi, me 58 vota për, 12 vota kundër dhe 8 abstenime, në vazhdimin e seancës plenare më 17 qershor 2016 e ka miratuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015.

## **16. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit raportin e paraqiti dhe e arsyetoi deputeti Armend Zemaj.

Raportin financiar e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani.

\* \* \*

Kuvendi, me 64 vota për, 8 vota kundër dhe 12 abstenime, në vazhdimin e seancës plenare më 17 qershor 2016 e ka miratuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015.

## **17. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Raportin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Xhevahire Izmaqi.

Raportin financiar e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani.

Lidhur me raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015 diskutoi edhe deputetja Selvi Halimi.

\*\*\*

Kuvendi, me 67 vota për, 8 vota kundër dhe 6 abstenime, në vazhdimin e seancës plenare më 17 qershor 2016 e ka miratuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015.

\* \* \*

Kryesuesi, para se të procedojë me shqyrtimin e pikave 18 dhe 19 të rendit të ditës, i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e pikave 18 dhe 19.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të LDK-së.

Lidhur me këtë propozim u deklaruan: Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, GP të LVV-së; Slavko Simiq, GP të LS dhe Mufera Shinik, GP “6+”.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 85,  
Kundër ----- 4,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës të bëhen me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe me nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1.1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë bëhet në seancën plenare më 17 qershor 2016.

1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës të bëhet në seancën plenare më 17 qershor 2016.

1.3. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit që ta shqyrtojë Projektligjin nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

1.4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës bëhet në seancën plenare më 17 qershor 2016, në orën 16:30.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **18. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-317 e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Selvije Halimi.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë diskutuan: Kryetari i Kuvendi, Kadri Veseli, kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, si dhe deputetët: Glauk Konjufca, Slavko Simiq, Xhevaire Izmaqu, Nuredin Ibishi, Faton Topalli, Blerta Deliu-Kodra, Alma Lama, Vjosa Osmani-Sadriu, Aida Dërguti, Mexhide Mjaku-Topalli, Arben Gashi, Shqipe Pantina, Hajdar Beqa, Muhamet Mustafa, Besa Baftiu, Bislim Zogaj, Gëzim Kelmendi, Mytaher Haskuka, Salih Salihu, Nait Hasani dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimin miratimin e këtij projektligji.  
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 84,  
Kundër ----- 6,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

### **V E N D I M**

Miratohet Ligji nr. 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

## **19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërliken me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-317 e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Selvije Halimi.

Nuk u lajmërua për debat asnjë deputet.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 84,  
Kundër ----- 5,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit që, në pajtim me vendimin e Kuvendit, nr. 05-V-317, ta shqyrtojë Projektligjin nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare të premtën, më 17 qershor 2016, në orën 15:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*